



TAKIMI

Deutsch- und Integrationskurs für albanischsprachige Frauen mit Kinderbetreuung
Kurs i gjuhës gjermane dhe i integritimit për gra shqipfolëse me përkujdesje të fëmijëve

TAKIMI

Kurs i gjuhës gjermane dhe i integritit për gra shqipfolëse me përkujdesje të fëmijëve

«Takimi» është një kurs i gjuhës gjermane dhe i integritit për gra shqipfolëse me përkujdesje të fëmijëve. Kursi ofrohet për gra me ose pa fëmijë, të cilat kanë ardhur në Zvicër në moshë madhore përmes martesës apo bashkimit familjar dhe si pasojë e situatës familjare, si gra shtëpiake dhe nëna nuk kanë patur mundësi të kenë kontakte me mjedisin gjermanofolës apo të mësojnë gjuhën gjermane.

Kursi ofrohet në nivelin A1 dhe zgjat një vit shkollor. Gjatë kursit të gjuhës gjermane ofrohet mundësia për përkujdesje të fëmijëve nga një edukatore e shkolluar. Këtu fëmijët do të mësojnë si të orientohen në një grup, të luajnë së bashku me fëmijët e tjerë, si dhe do të mësojnë gjermanisht në varësi të moshës, duke dëgjuar tregime, kënduar apo mësuar vjersha, gjë që do t'i ndihmojë shumë kur të fillojnë mësimin parashkollor.


Përveç kësaj kursantet kanë mundësi të këshillohen pa pagesë rreth profesionit, familjes, sistemit shkollor dhe social, etj. Herë pas here ata do vizitojnë institucione të ndryshme të rëndësishme të Bazelit.

«Takimi» iu mundëson kursanteve hapat fillestare të mësimit të gjuhës gjermane në një atmosferë të besueshme me një mësuese shqiptare të gjuhës gjermane, e cila me metoda krahasuese do t'ua bëjë sa më të kuptueshme gramatikën e gjuhës gjermane.

Të mësuarit e gjuhës gjermane ju mundëson të rrisni aftësinë tuaj komunikuese. Ky kurs ju mundëson të mësoni më shumë për jetën e vendit ku jetoni, për të drejtat tuaja, mundësitë e ofruara këtu, si dhe për detyrimet. Ky vetëdijësim kulturor do t'ju mundësojë njohjen e kulturës së popullit zviceran si dhe sistemin social, ekonomik e politik të shtetit.

Mësimi i gjuhës në vendin ku jetoni nuk do të thotë humbje identiteti, por përkundrazi përfitim të vetive qenësore si vetëbesim, pavarësi në komunikim, marrje të përgjegjësisive për vetveten dhe për familjen tuaj.

MIRË SE VINI!



Fillim i kursit	Gusht 2013
Kohëzgjatja e kursit	1 vit shkollor – 2 semestra (40 javë), pushimet sipas planit shkollor të Kantonit të Bazelit
Leksione	200 leksione mësim të gjuhës gjermane dhe 40 leksione me temë nga jeta në Zvicër
Intensiteti	2 herë në javë nga 3 leksione, ekskluzive temat rreth jetës në Zvicër
Vendi	ABSM, regjistrimi në Gempenstrasse 27 Klasët ku zhvillohet mësimi në Gempenstrasse 10
Pagesa	Kursi: duke filluar nga 500 Franga për një vit shkollor apo në raste të veçanta sipas marrëveshjes me Sozialdienste ose RAV Perkujdesja e fëmijëve: duke filluar nga 180 Franga për një vit shkollor apo në raste të veçanta sipas marrëveshjes me Sozialdienste ose RAV
Regjistrimi dhe testimi	Regjistrimin mund ta bëni personalisht në zyrën e ABSM, Gempenstrasse 27 apo online në www.absm.ch



FORMULARI APLIKUES

Unë regjistrohem për këtë kurs

Me perkujdesje të fëmijëve Moshë e fëmijës

Mbiemri:


Emri:

Adresa:

Vendbanimi:

Telefoni:

E-Mail:



 **SBB**
Basel SBB

ABSM

Gempenstrasse 27

4053 Basel

Tel.: 061 361 85 88

info@absm.ch

www.absm.ch

Öffnungszeiten Sekretariat:

MO – FR

09.00 – 12.00h / 13.30 – 17.00h



 **absm**
integriert mit Sprache und Bildung

Bitte frankieren

ABSM

Ausbildungs- und Beratungsstelle für
Migrantinnen und Migranten

Gempenstrasse 27

4053 Basel